



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.86/2024

Prishtinë, më 23.4.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Nasuf Bejta, Labinotë Demi-Murtezi, Fatmire Kollçaku dhe Ariana Musliu- Shoshi.

Munguan: Duda Balje, Drita Millaku, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Graiqevci- KKAFFZHK; Andin Hoti, KQPZH; Besarta Pllana, Kuvendi i Kosovës; Genti Ramosaj, GP AAK; Marigona Pajaziti, GP PDK; Shqipe Pajaziti- KoosvaPress dhe Antigone Isufi-Kallxo.com.

Mbledhjen e kryesoi Arjeta Fejza, nënkryetare e parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 8.4.2024;
3. Takim me përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, si dhe të Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur;
Të ftuar: Andin Hoti dhe Ahmet Grajqevci, me bashkëpunëtorë.
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Nënkryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 8.4.2024

Nënkryetarja, konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 8 prill 2024.

3. Takim me përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur si dhe të Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur; Të ftuar: Andin Hoti dhe Ahmet Grajqevci, me bashkëpunëtorë.

Nënkryetarja falënderoi përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe të Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur për prezencën në komision, tha se ky takim është i rëndësishëm, sepse do të diskutohet lidhur me shqetësimet që mund t'i kemi në adresimin e çështjes së personave të zhdukur. Më pas, fjalën ia kaloi z. Andin Hoti.

Andin Hoti, njoftoi se gjatë vitit 2023, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur në aktivitetet e tyre kanë pasur 15 gërmime në territorin e Republikës së Kosovës, në 15 lokacione. Ekipet e ekspertëve kanë arritur t'i zhvarrosin mbetjet mortore të mbi 20 personave. Të gjitha këto janë testuar dhe analizuar nga ekspertët e mjekësisë ligjore dhe janë dërguar për analizë të mëtuftjeshme në laboratorin e Komisionit Ndërkombëtarë për Personat e Zhdukur, që gjendet në Hagë. Për shumicën prej tyre janë pranuar rezultatet e disa prej tyre janë ende në pritje të rezultateve, janë dorëzuar mbetjet mortore të 9 personave të familjarët, gjatë vitit 2023.

Sa i përket territorit të Serbisë, fatkeqësisht është arritur me qenë në vetëm një lokacion, në atë të Shtavalles së Sienices, që ishim në nëntor të vitit të kaluar, kemi dyshime se aty mund të jetë një varrezë masive, për shkak të informacioneve të shumta që kemi për atë lokacion. Në këtë lokacion, gërmimet janë ndërprerë për herë të dytë dhe në çdo takim që kemi me përfaqësuesit e Serbisë, bëjmë kërkesë që të marrim informacione kredibile, që ata i kanë për këtë lokacion dhe të tjerat, dhe të rikthehemi prapë në lokacionet që ne dyshojmë.

Po ashtu njoftoi se në mars të vitit 2023, ka ndodhur një marrëveshje bazike. Të gjithë e dimë që ka ndodhur një aneks i Ohrit, ishte edhe vetë i pranishëm, dhe në kuadër të aneksit të Marrëveshjes së Ohrit, është një paragraf ku thuhet se çështja e personave të zhdukur duhet të trajtohet me urgjencë. Në zbatim të saj, më 2 maj të vitit 2023, tha se është miratuar një deklaratë në Bruksel për personat e zhdukur mes Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe presidentit të Republikës së Serbisë, dhe me një 1 qershor të vitit 2023, në zbatim të kësaj deklarate, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur i ka dërguar një letër z.Vuçiq, për të hapur arkivat, duke përfshirë edhe ato konfidenciale të ushtrisë, të brigadës 37, e cila ka operuar në Zonën e Drenicës. Kjo ka qenë vetëm fillimi i kërkesave tona në zbatim të deklaratës dhe në tendencë për t'i treguar Bashkimit Evropian, se presim ndërhyrjen e tyre, sepse ne e kemi pasur mendimin dhe vazhdojmë ta kemi edhe sot, se Serbia nuk ka vullnet të bashkëpunojë në këtë fushë. Këto dokumente, këto arkiva nuk i supozojmë ne, por këto kanë qenë publike, kanë qenë në media dhe i kërkojmë ato pikërisht për atë se na ndihmojnë për tek informacioni për të zbardhur fatin e personave të zhdukur, lokacionet e varrezave masive, që ne i kërkojmë në vazhdimësi.

Më tej, theksoi se në shtator të vitit 2023, i ka dërguar letër z. Borrell, që është ndërmjetësues pikërisht i deklaratës së personave të zhdukur, në janar të vitit 2024, e ka përsëritur letrën ndaj z. Borrell dhe edhe z. Lajçak për informimin për moszbatim të deklaratës nga ana e Serbisë, dhe fatkeqësisht as nga ana e z. Vuçiq e as nga z. Borrell dhe z. Lajçak nuk kemi pranuar asnjë përgjigjeje deri më sot, lidhur me moszbatimin e deklaratës për personat e zhdukur, e cila është miratuar me ndërmjetësimin apo para syve të tyre në Bruksel.

Gjithashtu, ai tha se në vitin 2023, Kosova është anëtarësuar në Komisionin Ndërkombëtarë për Personat e Zhdukur (ICMP), me të drejta të plota, në nëntor 2023, është mbajtur takimi i parë i ICMP-së, ku edhe Kosova si shtet ka marrë pjesë me të drejta të barabarta.

Më 31 janar të vitit 2024, me ftesë të z. Lajçak, kemi pranuar të mbajmë një takim të jashtëzakonshëm në Gjenevë, takim i ndërmjetësuar prej Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Takimi ishte i grupit punues, takime që kanë ndodhur më herët, mirëpo ka mbi dy vite që nuk mbahen dhe dje në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, është përmendur ky takim disa herë prej anëtarëve të Këshillit të Sigurimit. Takimi ka qenë mes delegacionit të Kosovës dhe delegacionit të Serbisë. Më tej, tha se ai nuk ishte i pranishëm e as z. Odallovic, e dini qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me z. Ovdalovic, dhe deri më sot, Serbia nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në raport me ndryshimin e pozitës së tij dhe as në këtë takim nuk kemi pranuar asnjë lloj informacioni nga pala serbe. Në këtë takim, tha se kanë kërkuar informacione për 16 lokacione në territorin e Serbisë, ku Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, në vitin 2001 pati thënë publikisht se ekzistojnë, dhe në 5 lokacione janë gjetur varreza masive dhe nuk e dimë a janë prej këtyre të 16-tave, sepse ne nuk i dimë, i dinë ata. Në 5 lokacione, deri më tani, në territorin e Serbisë është gërmuar dhe në 5 ka pasur varreza masive. Potencialisht edhe 11 të lokacione tjera ne vazhdojmë t'i kërkojmë, lokacione që vetë Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë i ka potencuar në media dhe delegacioni që ka qenë në bisedime në Gjenevë nuk është se ka pranuar ndonjë përgjigje nga pala serbe. Por, janë zotuar se në shqyrtim me qeverinë e tyre dhe organet kompetente, do të pranojnë të fillojnë gërmimet sipas zotimeve që i kanë marrë dhe atë në rajonin e Novi Pazarit, Rashkës, apo edhe rikthimin në Batajnicë, Petrovosello dhe Peruqas. Këto tri lokacione që në vitin 2001 janë gjetur përafërsisht 1000 persona të zhdukur, por ne dyshojmë se ka ende persona të mbetur në këto lokacione.

Ka qenë shumë i nevojshëm involvimi i Bashkimit Evropian, në mënyrë që ata të marrin këtë rolin e kushtëzimit, sepse ne, një gjë të tillë nuk mund ta bëjmë, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më sot.

Njoftoi se gjatë këtij viti është duke u punuar në 4 lokacione në territor të Kosovës, është arritur të bëhen dy dorëzime të personave të identifikuar dhe janë edhe 10 lokacione të tjera potenciale që aktualisht Policia e Kosovës, së bashku me ne, po punon në hulumtimin e informacioneve që i posedojmë.

Gjithashtu, ai njoftoi edhe për Ligjin për persona të zhdukur, i cili tha se ende nuk është përfunduar, por pritjet që shumë shpejt do të dalë për konsultime publike dhe janë afatet procedurale ligjore që duhet ndjekur dhe pastaj do të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Ahmet Graiqevci, tha se është ish- anëtar i Komisionit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës dhe Persona të Zhdukur, që 25 vite, nuk ka dashur të hiqet nga kjo detyrë për hir të interesit të kombit dhe atdheut, është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe arsyeja që e ka shtyrë të merrej me çështjen e personave të zhdukur, është fakti se nëna e tij,

gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte 29 anëtarë të familjes të zhdukur dhe asnjëherë nuk i ka gjetur.

Çështja e personave të zhdukur është një çështje jashtëzakonisht e dhimbshme dhe e mundimshme për familjarët, duke shtuar se asnjë qeveri, deri më sot, nuk ka bërë të duhurën për familjarët e të pagjeturve.

Tha se fillimisht kur u angazhua në këtë proces, ishin të panjohuar dhe nuk kishin dije, si të merren me këtë sfidë, por fatmirësisht një kolege norvegjeze erdhi dhe na ndihmoi sesi t'i qasemi këtij problemi, meqë ishte me përvojë pune në për zonat e luftës, përfshirë Bosnjë e Hercegovinë.

Kosova, pas luftës, kishte 6336 persona të zhdukur, gradualisht numri erdhi duke u zbritur, shumë prej tyre u gjetën nëpër puse të ndryshme, që i quajtëm pusët e vdekjes, nëpër shtëpi të djegura apo krematoriume që institucionet tona nuk i shenjzuan ato shtëpi dhe ata bunarë, si dhe vendet e masakrave ku ishin bërë. Kjo mundësi ishte dhe sadopak u munduan të mblidhnim materiale video-incizime, që në të ardhmen do t'i hynin shtetit në punë, ndonëse me vonesë, të gjitha argumentet janë në letër. Ai tha se e habit fakti që as nga Parlamenti e as nga Qeveria, për 5 vite është hapur ekspozita për krimet e luftës dhe persona të zhdukur dhe vetëm 5 apo 6 deputetë e kanë vizituar dhe të tjerët jo. Këtu është interesimi që tregon pasqyrën se kush jemi ne.

Tha se kemi kërkuar shumë herë nga bashkësia ndërkombëtare, që të bëjë trysni mbi Serbinë, sepse ajo është kryerësja e këtyre veprave, gjithçka ka kryer në mënyrë komanduese dhe të gjitha i ka në letër, të filmuar dhe të shënuar mirë. Ka komandantë, policë dhe ushtarakë që na informojnë se këtu mund të jetë varreza masive, kemi dëshmitarë edhe nga ata të gjallë që janë kthyer nga burgjet. Ky proces do punë të madhe të të gjitha institucioneve, që t'i gjejmë këta persona e t'iu ndihmojmë familjarëve, sepse me të vërtetë është bërë gjatë.

Këshilli koordinues rreth vetes ka 23 organizata që merren me çështjen e personave të zhdukur dhe krimeve të luftës, sado që është bërë nuk kemi përfunduar procesin në Republikën e Kosovës e Prokuroria ka punë me vite.

Vetëm në Fushë-Kosovë, tha se janë 9 shtëpi krematorium, nuk ka komunë që si ka minimumi 3 shtëpi krematorium, nuk ka fshat që nuk e ka në minimum një shtëpi krematorium dhe ne sot jemi mbrapa me vetveten, sepse institucionet tona nuk kanë punuar sa duhet dhe as sot nuk punojnë sa duhet.

Arjeta Fejza, tha se vazhdimisht kemi përcjellë qasjen e Serbisë në raport me obligimet të cilat i ka marrë në aspektin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën dhe shkeljen e vazhdueshme që ka bërë ndaj Marrëveshjes së Ohrit, madje edhe sulmit dhe agresionit ndaj Republikës së Kosovës, Bashkimi Evropian duhet ta shtojë trysnin ndaj Serbisë dhe ta bindë Serbinë që kjo çështje të marrë drejtim të zgjidhjes. Si komision, për çdo gjë jemi së bashku për adresimin e kësaj çështjeje.

Ariana Musli- Shoshi, tha se iniciativa për fatin e personave të zhdukur, mund të themi se ka ngelur si temë e fjetur nga kjo qeveri, dhe sa i është dhënë përparësi shihet nga ajo se Projektligji për personat e zhdukur ka pasur të dorëzohet në muajin maj të vitit 2023, pastaj është shtyrë për nëntor të vitit 2023 dhe tani ky projektligj ka hyrë në strategjinë legislative, tek në nëntor të vitit 2024.

Ajo shtoi se edhe herën e fundit, kur është trajtuar kjo temë në komision, ka pyetur, por nuk ka marrë përgjigje nga Komisioni Qeveritar, lidhur me marrëveshjen për personat e zhdukur, që tha se ende s'e kanë parë zyrtaren dhe janë njoftuar nga z. Bislimi, në Komisionin për Punë të Jashtme, se janë ende duke u bërë disa marrëveshje, sa i përket termit të zhdukurit me dhunë dhe vetëm të zhdukurit. Dihet që në të drejtën

ndërkombëtare, këto dy terma kanë dallime të mëdha sa u përket obligimeve shtetërore dhe pyeti se kur ka qenë takimi i fundit që z. Besnik Bislimi e ka trajtuar këtë temë në Bruksel me shtetin serb apo edhe me përfaqësuesit e BE-së Lajcak dhe Borrell. Po ashtu, pyeti z.Hoti: Që nga marrja e mandatit, cilat janë rezultatet apo ngecjet që ka hasur në këtë proces?

Andin Hoti, tha se në emër të z. Bislimi nuk mund të flasë. Marrëveshja për personat e zhdukur është publike, që nga 2 maji i vitit 2023, në institucionet e BE-së.

Në deklaratën për personat e zhdukur, e miratuar në Bruksel, tha se termat personat e zhdukur dhe personat e zhdukur me dhunë, ka qenë një nga problemet kryesore që Serbia nuk ka pranuar, por në deklaratë, termi personat e zhdukur me dhunë, ekziston.

Arjana Musliu- Shoshi, pyeti: A është termi të zhdukurit me dhunë apo të zhdukurit me forcë?

Andin Hoti, tha se termin të zhdukurit me forcë apo me dhunë, e ka konsideruar dhe vazhdon ta konsiderojë se është i njëjtë.

Ariana Musliu- Shoshi, tha se këto terme, në të drejtën ndërkombëtare, kanë dallim.

Andin Hoti, tha se Ligji për personat e zhdukur, që 7 vite është në procedurë të ndryshim- plotësimit. Problemi që projektligji nuk është ende në Kuvend, nuk ka të bëjë me neglizhencën e Komisioni Qeveritar, por ka të bëjë me tendencën për të përshtatur kërkesat e shoqatave dhe familjarëve të personave të zhdukur, në raport me Ligjin për personat e zhdukur.

Fatmire Kollçaku, tha se për çështjen e personave të zhdukur, vuajtjet dhe dhimbjet për ta nuk përfundojnë deri në gjetjen e të gjithë të zhdukurve. Si Kuvend, tha se jemi të përkushtuar dhe qeveria ka vullnet dhe duhet të punojë në këtë drejtim. Po ashtu, tha se e mbështesin Projektligjin për persona të zhdukur dhe kur të procedohet në Kuvend, do të japin kontributin që të bëhet më e mira për mbështetjen e familjeve të personave të zhdukur.

Ahmet Grajqevci, tha se 4000 dosje të gatshme rrinë për kriminelët e luftës. Prokurorët tanë nuk ndërmarrin veprime dhe nuk iniciojnë padi. Këtu janë njerëzit të cilët e kanë bërë krime dhe tha se kjo e mërzit shumë, sepse askush nuk i kërkon materialet. Ne, ato nuk i kemi për t'i mbajtur në sirtar. Mbi 25000 foto të krimeve, me mijëra orë film, të gjitha këto rrinë në sirtar. Kërkoj nga ju, si Parlament, të kërkonit se ku janë materialet e Komisionit për Krime Luftë, që i kemi tubuar, kërkoj punën time që e kam kryer dhe nuk e gjej askund. Po ashtu, tha se është autor i asaj që mund të dëshmojë se çka ka parë aty dhe ato nuk janë askund. Fatbardhësisht, tha se i ka mbajtur 120 mijë apo 130 mijë faqe, por për 2.5 milionë faqe nuk e di ku janë.

Fatmire Kollçaku, tha se inkurajon Komisionin Qeveritar, por edhe Këshillin Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur, që me gjithë këto të dhëna, të aktivizoni mundësinë e Institutit të Krimeve të Luftës, që t'i inkurajojmë qytetarët që të deponojnë fakte, sepse qytetarët kanë ende shumë dëshmi dhe t'i deponojnë ato, sepse kemi shumëçka të themi, sepse nuk ka familje që nuk është prekur në forma të ndryshme gjatë kohës së luftës.

Arjeta Fejza, njoftoi se si komision parlamentar, shumë shpejt do të kemi një takim me Këshillin Prokurorial të Kosovës, për t'i adresuar pikërisht këto çështje, që u diskutuan në këtë takim, efektivitetin në ngritjen e aktakuzave dhe në adresimin e krimeve të luftës.

Albana Bytyçi, tha se në takimin e fundit, thajse para një viti, kur ishin prezent përfaqësuesit e Komisioni Qeveritar, është thënë se Projektligji për personat e zhdukur është çështje javësh, që do të procedohet në Kuvend. Më tutje, pyeti: Ky projektligji, përveç pensioneve, cilat janë kërkesat tjera të familjareve të personave të zhdukur? Pyeti z. Hoti: Në sa takime ka marr pjesë në Bruksel, prej vitit të kaluar, kur ishte takimi i fundit që kanë takuar familjarët e personave të zhdukur dhe cilat janë punët e mira që janë bërë prej se jeni në këtë pozitë dhe çka ju ka mbetur brengë për ta zgjidhur në të ardhmen?

Andin Hoti, tha se kur kemi folur për projektligjin, në atë kohë, projektligji është kthyer nga Ministria e Drejtësisë në Komisionin Qeveritar, gjegjësisht Zyrës së Kryeministrit dhe është themeluar grupi punues. Grupi punues, në dhjetor të vitit 2023, veç i ka përmbyllur komentet e tij në raport me projektligjin.

Përveç benefiteve, familjarët po kërkojnë me të drejtë, ta kenë të drejtën e pensionit të moshës, janë edhe përkrahjet tjera që ata kërkojnë të jenë të barasvlershme me kategoritë e tjera të dala nga lufta, si shëndetësi, transport publik, arsimim etj.

Njoftoi se në vitin 2024 nuk ka qenë asnjëherë në takimet në Bruksel, në vitin 2023, tha se ka qenë tri herë. Në pyetjen çka e bën të ndjehet mirë, tha se kjo është diçka e rëndë për të dhe në këtë proces nuk ndihet mirë, sepse brengat e tij janë derisa të zgjidhet fati i personit të fundit që është i zhdukur, i cilitdo nacionalitet që është, e natyrisht se breng personale e ka babanë e tij.

Nasuf Bejta, tha se të gjitha këto masakra që kanë ndodhur mbi popullin shqiptar në 150 vitet e fundit, që nga gjenocidi mbi shqiptarët në Sanxhakun e Nishit, gjenocidi i Tivarit, gjenocidi i Rankoviqit në sistemin komunist, gjenocidi mbi popullatën çame në Greqi, Lufta e Dytë Botërore dhe gjykimi që iu bë kriminelëve në procesin e Nurembergut, tha se do të kishte shtruar një pyetje: a thua vallë edhe çka do të duhej të ndodhë mbi këtë popull që faktori ndërkombëtar të gjykojë drejt dhe të vlerësojë ashtu siç duhej? A u gjykua dikush për këto gjenocide në këto treva të Ballkanit? Jo, përkundrazi u stimuluan, ju dhanë territore, u ledhatuan dhe ju dhanë edhe benefite. Ne vetëm qëndruam në pragun tonë dhe prapë në këtë shekull të inteligjencës artificiale, në një Evropë që thirret për shumë demokraci, të vriten njerëzit, të nxirren prej burgut, të vriten nëpër kolona, t'u merren kufomat dhe mos të vlerësohet drejt një problem i tillë, tha se vërtet e shtron pyetjen kah po shkon kjo Evropë? Duke shtuar se këta po ledhatohen e ne po ndëshkohemi, andaj mendimi i tij personal është se ju keni bërë punë shumë të madhe në ndriçimin e kësaj çështjeje. Nuk është neglizhenca e institucioneve dhe asnjë shqiptari, por faktori ndërkombëtar nuk është i interesuar ta zgjidhë këtë problem.

Labinothë Demi- Murtezi, tha se me disa kolegë ka parë ekspozitën në zyrat e Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur. Ajo ekspozitë është shumë domethënëse. Më tej, tha se duke e ditur një realitet dhe duke mos pasur mundësi të veprohet karshi realitetit, me të vërtet është e rëndë. E dimë që krimet e luftës nuk vjetërsohen, ato mbeten krime dhe u bë një çerek shekulli, ne diskutojmë e trajtojmë, çështjen e njëjtë. Nuk është lehtë as për qeveritarët, e as për familjarët. Tha se është themeluar Instituti për Krime Luftë, është bërë ligji. Cilat janë raportet e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur? Për gjithë këto vite, qeveritë tona a kanë dërguar

ndonjë student për shkollim jashtë vendit, për të krijuar ekspertë në këtë fushë, që pastaj ata të kthehen e të japin kontribut, si ekspert, së paku për ato masakra që kanë ndodhur në territor të Kosovës?

Ahmet Grajqevci, tha se që nga fillimi kur ishte ekspertja norvegjeze, ka kërkuar që të kyçen studentë dhe nuk janë kyçur. Është interesant se 11 studentë nga Bashkimi Evropian kanë studiuar dhe doktoruar me tragjedinë dhe dhimbjen tonë. Ai tha se ka kërkuar te rektorët, dekanët, që të dërgojnë studentë të kriminalistikës, të drejtësisë dhe të ekonomisë në trajnime, që t'i kemi të gatshëm, sidomos në vitin 2008 dhe deri në vitin 2023, dhe asnjë nuk e kemi.

Në fund, tha se dy djem që i kanë ndihmuar gjatë rrugëtimit të tij, të dytë kanë magjistruar në krimet e luftës, por për fat nuk gjetën vend të punës këtu dhe janë detyruar të dalin jashtë Kosovës.

Andin Hoti, tha se me të vërtetë kanë mungesë te kuadrove, Kosova ka vetëm dy antropologë. Kjo fatkeqësisht, sepse studentët nuk preferojnë në Kosovë këtë drejtim dhe do të ishte mirë që së bashku të gjejmë një metodë të inkurajimit të studentëve, që në të ardhmen, t'i zgjedhin këto profesione dhe të kemi më shumë kuadro.

Për Institutin e Krimeve të Luftës, tha se prej ditës kur ka filluar, kanë qenë pjesë e grupit punues dhe edhe tash me rregulloren që instituti e ka përfunduar, ju kanë ofruar bashkëpunimin e plotë dhe gjithë dokumentacionin që Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, që posedon, do të jenë të gatshëm t'i ofrohen edhe Institutit për Krime të Luftës.

Arjeta Fejza, tha se si komision, shprehin shqetësimin e thellë dhe shpreh gatishmërinë për bashkëpunim, që të ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe të marrin përsipër që edhe në takimet që do t'i kemi, të adresojmë çështjen e trysnisë e që është e domosdoshme t'i bëhet Serbisë, edhe themelimin e komisionit të përbashkët, edhe përgjegjësinë që e ka si shtet, në këtë drejtim.

4. Të ndryshme

Arjeta Fejza, tha se më datë 30 prill 2024, do të kemi takimin me përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe me ministren e Drejtësisë.

Po ashtu, njoftoi se të gjithë deputetë kanë pranuar një ftesë lidhur me datën 27 prill, që shënohet Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur në Kosovë. Aktiviteti qendror do të mbahet në Meje dhe është mirë që në mënyrë të organizuar, të marrin pjesë si anëtarë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.*

Duda BALJE,

Kryetare e Komisionit